



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 150 /2011

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr.28/2008 nenit 11, 12, 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 32.5, 74, Rregulloren për Punë të Kuvendit neni 15, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RREGULLORËS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

I

Miratohet Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Hanit të Elezit. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për aplikim, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të bursave, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës.

II

Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Hanit të Elezit e përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi është hartuar nga Drejtoria për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport e cila përmban gjithsej 14 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport.

IV

Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

V

Më këtë Vendim njoftohen: Drejtoria për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

